



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 87

Tiranë – E premte, 9 qershor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Kulturës nr. 338, datë 2.6.2023	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.....
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 355, datë 7.6.2023	Për delegim kompetence.....
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 111, datë 6.6.2023	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e impiantit fotovoltai, me kapacitet prej njëqind e dyzet (140) mwp në Remas – Karavasta, Lushnjë”.....
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 150, datë 28.4.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Kurum International” sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”.....
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 151, datë 28.4.2023	Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.....
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 152, datë 28.4.2023	Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.....
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 153, datë 28.4.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Duka T2” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 12, datë 23.1.2020 dhe modifikimin e licencës nr. 190, seria PV13K, për prodhimin e energjisë elektrike

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 156, datë 2.5.2023	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	9495
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 179, datë 29.5.2023	Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike, për vitin 2023.....	9496
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 180, datë 29.5.2023	Mbi kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., për miratimin e rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”.....	9498
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 182, datë 29.5.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri” degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	9499
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 183, datë 29.5.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri” degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike	9500
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 184, datë 29.5.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar	9502
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 185, datë 29.5.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar.....	9503



UDHËZIM

Nr. 338, datë 2.6.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE PROCEDURAVE PËR MARRJEN E
LICENCËS PËR ADMINISTRIMIN
KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË
AUTORIT, RIPËRTËRITJEN E SAJ, SI
DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE PËR PEZULLIMIN DHE
HEQJEN E LICENCËS NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR
TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË
DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME
TO”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2 të nenit 158, të nenit 159/1 dhe të nenit 188 të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

A. Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim përcakton kriteret dhe procedurat për marrjen dhe/ose ripërtëritjen e licencës nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv (këtej e tutje “AAK”), si dhe kriteret dhe procedurat për rastet që përbëjnë kusht për pezullimin apo heqjen e licencës të AAK-së, në zbatim të neneve 133, 134, 135, 159 dhe 159/1, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.

B. Kriteret për marrjen e licencës si AAK:

1. Për të kryer administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, organizata jofitimprurëse, përveç sa është parashikuar në nenet 131, 133, 134 dhe 135 të ligjit 35/2016, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, duhet të plotësojë kriteret si vijon:

a) disponon kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtave, të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre, sipas ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, i ndryshuar. Këto kontrata do të shoqërohen me lista të plota të titujve të veprave të cilat do të administrohen;

b) dëshmon shprehjen e vullnetit për përfaqësim reciprok me agjencitë e huaja, në gjuhën shqipe;

c) ka kushte të përshtatshme dhe pajisje teknologjike për të kryer funksionet e saj;

ç) ka ekspertizë profesionale me një punonjës jurist dhe financiar të dokumentuar me dokument punësimi, njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse;

d) deklaron se ka përcaktuar rregulla për shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimeve, në mënyrë të drejtë dhe transparente, bazuar në përdorimin e veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit dhe objekteve të tjera të lidhura me to;

dh) deklaron se ka përcaktuar rregulla dhe ka mekanizma të mjaftueshëm për të monitoruar përdorimin të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to;

e) vërteton plotësimin e kriterëve të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, të germës B, brenda 6 (gjashtë) muajve nga marrja e licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to”;

ë) dokumentacioni i parashikuar në shkronjën “a” dhe “b”, të kësaj pike, do të shoqërohet me listën e plotë të titujve të veprave të cilat do të administrohen, jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj nga marrja e licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to;

f) depoziton pagesën e tarifës për aplikim për licencim të organizatës si AAK, sipas akteve nënligjorë në fuqi që miratojnë këto tarifa;

2. Drejtori ekzekutiv i AAK-së plotëson kriteret e mëposhtme:

a) është shtetas shqiptar;

b) ka vendbanim në Republikën e Shqipërisë.

C. Kriteret për ripërtëritjen e licencës së AAK-ve

1. Për ripërtëritjen e licencës, për të kryer administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, AAK-ja, përveç përmbushjes së të gjitha kushteve të pikave 1 dhe 2 të germës B të këtij udhëzimi, duhet të provojë dhe përmbushjen e kriterëve si vijon:

a) deklaron zbatimin e akteve në fuqi në lidhje me organizimin e brendshëm për sa i përket:

i. aktivitetit të Asamblesë së Përgjithshme;

ii. përzgjedhjes dhe/ose shkarkimit të organit ekzekutiv;



iii. mbikëqyrjes së administrimit ekonomik-financiar të agjencisë;

iv. shqyrtimit të ankesave në lidhje me kryerjen e funksionit të agjencisë;

v. zbatimit të rregullave ligjore në lidhje me shpenzimet administrative të agjencisë;

vi. zbatimit të dispozitave ligjore në lidhje me transparencën dhe informimin e mbajtësve të të drejtave, përdoruesve dhe publikut;

vii. zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me jo anëtarët e të njëjtës kategori.

b) depoziton raportin dhe bilancin vjetor;

c) vërteton së ka shlyer detyrimet për agjencitë simotra në kuadër të marrëveshjeve reciproke.

Ç. Procedura për aplikim për licencë apo ripërtëritje të saj.

1. Ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit, njofton nëpërmjet thirrjes publike të gjithë subjektet që mund të kenë interes për pajisjen me licencë apo ripërtëritje të saj për kategorinë përkatëse për të drejtat e autorit apo të drejtave të tjera të lidhura me to.

2. Subjektet e interesuar dhe AAK-të paraqesin kërkesën për licencim apo ripërtëritje të saj, me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë për shprehje interesi;

b) formularin e aplikimit sipas formatit të miratuar, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

c) dokumentacionin shoqërues, i cili vërteton përmbushjen e të gjitha kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 35/2016, i ndryshuar dhe në shkronjën B dhe C të kreut I të këtij udhëzimi;

3. Afati për depozitim të kërkesave dhe plotësimin e plotë të dosjes së aplikimit për licencim ose ripërtëritjen e saj është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e publikimit të thirrjes në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit. Për shkaqe objektive dhe të justifikuara, ministri përgjegjës për të drejtën e autorit mund të shtyjë afatin e dorëzimit të dokumentacionit, i cili publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit.

4. Dokumentacioni depozitohet pranë protokollit të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit.

a) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, ngre grupin e punës për shqyrtimin e kërkesave për licencimin apo ripërtëritjen e licencës së AAK-ve dhe përcakton afatet për shqyrtimin e

dokumentacionit, në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”;

b) brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e ministrit, kryhet shqyrtimi i dokumentacionit dhe i paraqiten ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit propozimet për miratimin e licencimit;

c) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit vendos me urdhër për licencim ose ripërtëritje të licencës së AAK-së;

ç) urdhri i ministrit për licencim apo ripërtëritje të licencës hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në Qendrën Kombëtare të Licencimit.

II. PEZULLIMI OSE HEQJA E LICENCËS SË AAK-së

A. Kushtet dhe procedura për pezullimin e licencës së AAK-së

1. Licenca e një AAK-je pezullohet në rastet kur konstatohen përsëritje të shkeljeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 159/1, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar,

2. Procedura e pezullimit të licencës së një AAK-je:

a) në rast se Drejtoria për të Drejtën e Autorit (në vijim DDA), konstaton shkelje të përsëritura sipas përcaktimeve në pikën 1 të nenit 159/1 të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, i propozon Ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit fillimin e procedurës për pezullim licence;

b) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit ngre menjëherë grupin e punës për zhvillimin e procedurës administrative për pezullimin ose jo të licencës;

c) grupi i punës zhvillon procedurën administrative në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”;

ç) grupi i punës në përfundim të procedurës administrative, harton një raport të detajuar të cilin ia përcjell DDA-së.

d) DDA-ja bazuar në raportin e grupit të punës, në varësi të rrethanave i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit pezullimin për 3 (tre) muaj të licencës.

dh) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit urdhëron pezullimin ose jo të licencës së AAK-së;

e) AAK-së ndaj së cilës është marrë masa e pezullimit të licencës, gjatë periudhës së pezullimit,



humbet të drejtën të ushtrojë funksionet për të cilat është licencuar.

ë) urdhri i ministrit për pezullimin e licencës hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

B. Kushtet dhe procedura për heqjen e licencës së AAK-së

1. Licenca e një AAK-je: hiqet në rastet kur konstatohen shkelje të parashikuara të pikën 2, të nenit 159/1, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.

2. Procedura për heqjen e licencës së një AAK-je është si më poshtë:

a) në rast se DDA, konstaton shkelje të përcaktuara në pikën 2, të nenit 159/1, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, i propozon Ministrin përgjegjës për të drejtën e autorit fillimin e procedurës për heqje licence;

b) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit ngre menjëherë grupin e punës për zhvillimin e procedurës administrative;

c) grupi i punës zhvillon procedurën administrative në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”;

ç) grupi i punës njofton me shkrim të gjitha palët në proces për fillimin e veprimeve në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;

d) grupi i punës në përfundim të procedurës administrative, harton një raport të detajuar të procedurës dhe gjetjeve të cilin ia përcjell DDA-së;

dh) DDA-ja bazuar në raportin e grupit të punës, në varësi të rrethanave, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit heqjen e licencës së AAK-së;

e) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, bazuar në raportin e grupit të punës dhe në

njoftimin e DDA-së urdhëron për heqje ose jo të licencës së AAK-së;

ë) AAK-së ndaj së cilës është marrë masa e heqjes së licencës humbet të drejtën të ushtrojë funksionet për të cilat është licencuar;

f) AAK-ja ndaj së cilës është marrë masa për heqjen e licencës humbet të drejtën për aplikim për pajisje me licencë për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare) nga data e hyrjes në fuqi të urdhrit të ministrit;

g) urdhri i ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

III. DISPOZITAT KALIMTARE

1. Në rast mos licencimi apo mos ripërtëritje të licencës, kërkuesi ka të drejtën e ankimit sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

2. AAK-së së cilës i është pezulluar apo hequr e drejta për të ushtruar veprimtari të administrimit kolektiv, ka të drejtën e ankimit. Ankimi në gjykatë nuk pezullon aktin administrativ, përveç kur vendoset ndryshe nga gjykata kompetente.

3. Udhëzimi nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, ‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to’, i ndryshuar”, shfuqizohet.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËSFORMULAR APLIKIMI PËR LICENCIMIN E AGJENCIVE TË ADMINISTRIMIT
KOLEKTIV PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË
LIDHURA ME TOData e aplikimit _____
(data, muaji, viti)Data e dorëzimit _____
(data, muaji, viti)

A. INFORMACION MBI ORGANIZATËN JOFITIMPRURËSE

1. Të dhënat e organizatës jofitimprurëse:

a. Emri: _____,

(organizatë jofitimprurëse, sipas neneve 133 dhe 134, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” i ndryshuar, si dhe udhëzimit të ministrit të Kulturës nr. _____, datë _____._____)

b. Data e themelimit: _____._____

c. Të dhënat e identifikimit të themeluesve (emër, mbiemër / emër i personit juridik): _____

ç. Selia (adresa): _____

d. Tel: _____

dh. e-mail: _____

e. Faqja e internetit: _____

ë. Përfaqësuesi ligjor i organizatës jofitimprurëse: z./znj. _____

2. Objektivat dhe qëllimet e OJF-së: _____

3. Kategoria e të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to, që kërkoni të administroni në emër të mbajtësit të së drejtave të autorit/të drejtave të lidhura me to (përshkrim i kategorisë përkatëse dhe të drejtave të administruara): _____

B. DOKUMENTET SHOQËRUESE (*bashkëlidhur këtij aplikimi*)

1. Vendimi i gjykatës për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse;

2. Akti i themelimit, rregullorja e brendshme dhe statuti i organizatës jofitimprurëse, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, për të drejtat e autorit dhe organizatat jofitimprurëse, në të cilën duhet parashikuar edhe metodologjia e shpërndarjes së shpërblimeve;

3. Ekstrakt të organizatës jofitimprurëse;

4. Vërtetim të llogarisë/ve bankare përkatëse për kryerjen e veprimeve financiare;



5. Kopje e letërnjoftim ID/pasaportës të drejtorit ekzekutiv;

6. Deklaratë mbi aktivitetin e OJF-së ku përcakton se administrimi kolektiv i të drejtave është aktiviteti i saj i vetëm, përveç rastit kur veprimtaritë e tjera të saj janë në fushën e artit dhe kulturës;

7. Kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtave, të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre, sipas ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, i ndryshuar. Këto kontrata do të shoqërohen me lista të plotë të titujve të veprave të cilat do të administrohen;

8. Dokumentacionin e nevojshëm, në gjuhën shqipe, që dëshmon shprehjen e vullnetit për përfaqësim reciprok me agjencitë e huaja;

9. Vërteton plotësimin e kriterëve të parashikuara në pikën 8 të këtij formulari, brenda 6 (gjashtë) muajve nga marrja e licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to;

10. Dokumentacioni i parashikuar në pikën 9 të këtij formulari, do të shoqërohet me listën e plotë të titujve të veprave të cilat do të administrohen, jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj nga marrja e licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to;

11. Dokument provues të funksionimit të OJF-së, që lidhet me:

a. hapësirën dhe logjistikën e përshtatshme;

b. mekanizma të mjaftueshme për mbledhjen, shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimit;

c. shërbimin teknik dhe pajisje teknologjike;

ç. ekspertizën profesionale me një punonjës në fushën financiare dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj, të vërtetuar me dëshmitë përkatëse.

12. Depoziton pagesën e tarifës për aplikim për licencim të organizatës si AAK, në përputhje me vendimin nr. 33, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.

(Emri, mbiemër, firmë, vulë, përfaqësuesit ligjor)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS**FORMULAR APLIKIMI PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS NGA AGJENCITË E
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E
TJERA TË LIDHURA ME TO**Data e aplikimit _____
(data, muaji, viti)Data e dorëzimit _____
(data, muaji, viti)**A. INFORMACION MBI ORGANIZATËN JOFITIMPRURËSE****1. Të dhënat e organizatës jofitimprurëse:**

a. Emri: _____,

(organizatë jofitimprurëse, sipas neneve 133 dhe 134 të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” i ndryshuar, si dhe udhëzimit të ministrit të Kulturës nr. _____, datë _____._____._____)

b. Data e themelimit: _____._____._____

c. Të dhënat e identifikimit të themeluesve (emër, mbiemër / emër i personit juridik): _____

ç. Selia (adresa): _____

d. Tel: _____

dh. e-mail: _____

e. Faqja e internetit: _____

ë. Përfaqësuesi ligjor i organizatës jofitimprurëse: z./znj. _____

2. Objektivat dhe qëllimet e OJF-së: _____**3. Kategoria e të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to, që kërkoni të administroni në emër të mbajtësit të së drejtave të autorit/të drejtave të lidhura me to (përshkrim i kategorisë përkatëse dhe të drejtave të administruara):**_____

_____**B. DOKUMENTET SHOQËRUESE (bashkëlidhur këtij aplikimi)****1. Vendimi i gjykatës për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse;****2. Akti i themelimit, rregullorja e brendshme dhe statuti i organizatës jofitimprurëse, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, për të drejtat e autorit dhe organizatat jofitimprurëse, në të cilën duhet parashikuar edhe metodologjia e shpërndarjes së shpërblimeve;****3. Ekstrakt të organizatës jofitimprurëse;**



4. Vërtetim të llogarisë/ve bankare përkatëse për kryerjen e veprimeve financiare;
5. Kopje e letërnjoftim ID/pasaportës të drejtorit ekzekutiv;
6. Deklaratë mbi aktivitetin e OJF-së ku përcakton se administrimi kolektiv i të drejtave është aktiviteti i saj i vetëm, përveç rastit kur veprimtaritë e tjera të saj janë në fushën e artit dhe kulturës;
7. Kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtave, të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre, sipas ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, i ndryshuar. Këto kontrata do të shoqërohen me lista të plota të titujve të veprave të cilat do të administrohen;
8. Dokumentacionin e nevojshëm, në gjuhën shqipe, që dëshmon shprehjen e vullnetit për përfaqësim reciprok me agjencitë e huaja;
9. Dokumente provues për respektimin e marrëdhënieve të reciprocitetit me agjencitë e huaja me të cilat është lidhur marrëveshje/kontratë përfaqësimi”;
10. Vërtetim për shpërndarjen e detyrimeve për agjencitë simotra në kuadër të marrëveshjeve reciproke, si dhe ka kryer shpërndarjen e të ardhurave të pashpërndara;
11. Dokument provues të funksionimit të agjencisë, që lidhet me:
 - a. hapësirën dhe logjistikën e përshtatshme;
 - b. mekanizma të mjaftueshme për mbledhjen, shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimit;
 - c. shërbimin teknik dhe pajisje teknologjike;
 - ç. ekspertizën profesionale me një punonjës në fushën financiare dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj, të vërtetuar me dëshmitë përkatëse.
12. Dokumente provues për përmbushjen/zbatimin e parashikimeve të ligjit për të drejtën e autorit për ushtrimin e administrimit kolektiv dhe të legjislacionit në fuqi.
13. Deklarimin lidhur me gjendjen gjyqësore të drejtorit ekzekutiv;
14. Njësitë përbërëse të administratës së agjencisë, kontratat e punës dhe niveli i pagave të tyre;
15. Deklaratë e gjendjes financiare aktuale të nënshkruar nga drejtuesi i Agjencisë;
16. Pasuritë e paluajtshme në emër të agjencisë, të vërtetuar me certifikatë pronësie;
17. Performancën në lidhje me shpenzimet e kryera në ushtrim të objektit të licencës;
18. Transparencën e bilanceve, informacionit dhe raportimit me organet e tjera shtetërore;
19. Pagesa e tarifës për aplikim për ripërtëritjen e licencës të organizatave si agjenci e administrimit kolektiv, në përputhje me vendimin nr. 33, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.
20. Procese gjyqësore me objekt cenimi të së drejtave të mbrojtura nga agjencia;

Po---- _____ Jo _____ (Numri i tyre nëse po) _____

21. Nëse keni listoni dhe paraqisni bashkëlidhur kopje të vendimeve të përditësuara të gjykatës:

(Emri, mbiemër, firmë, vulë, përfaqësuesit ligjor të agjencisë)

**URDHËR****Nr. 355, datë 7.6.2023****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Mejvis Kola, drejtor i përgjithshëm:

a) të nënshkruajë autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjyqimit të kësaj çështjeje, si edhe t'i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga znj. Mejvis Kola, drejtor i përgjithshëm, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit;

b) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore dhe të huaja për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e koncesioneve dhe partneritetin publik privat me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

d) autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë qendrës së punës, brenda vendit të punës, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit;

Faqe|9484

e) të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

f) të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon ministrit;

g) të ndjekë procedurat e lidhjes së marrëveshjeve të posaçme (MEA), për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

h) të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

2. Këto kompetenca të ushtrohen nga znj. Mejvis Kola, drejtor i përgjithshëm, duke filluar nga data 7.6.2023.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

4. Urdhri nr. 311, datë 17.5.2022, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet znj. Mejvis Kola, drejtor i përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM**Nr. 111, datë 6.6.2023**

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE
“PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN,
NDËRTIMIN, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN
E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET PREJ NJËQIND E DYZET
(140) mwp NË REMAS – KARAVASTA,
LUSHNJË”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- znj. Delina Ibrahimajkryetare;
- znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- znj. Brikena Qelaanëtare;
- znj. Inida Methoxhaanëtare;



- z. Ahmet Maçeçllarianëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 6.6.2023, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 22.8.2022, “Për Ndhimën Shtetërore”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 199, datë 9.1.2023, njoftimin e ndihmës shtetërore për projektin “Për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e impiantit fotovoltai, me kapacitet prej njëqind e dyzet (140) mwp në Remas – Karavasta, Lushnjë”.

Baza ligjore për njoftimin e ndihmës: ligji nr. 7/2017, “Për promovimin e energjisë nga burimet e rinovueshme”; vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.6.2018, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”; si edhe urdhri i ministrit të MIE-s nr. 336/1, datë 20.12.2019, për themelimin e një komisioni të posaçëm për të zhvilluar një procedurë konkurruese, “Për përzgjedhjen e projektit që do të marrë masat mbështetëse për ndërtimin e impiantit fotovoltai në zonën e Karavastës dhe të Libofshës”, në emër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë bazuar në ligjin e burimeve të rinovueshme dhe VKM-në nr. 349.

Komisioni shqyrtoi planin e ndihmës shtetërore të sipërcituar, duke vlerësuar përputhshmërinë e saj me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe:

VËREN SE:

1. Në përputhje me Vendimin nr. 349 datë 12 Qershor 2018 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre” (“VKM 349”), MIE ka ftuar ofertuesit të dorëzojnë ofertat e tyre në një procedure konkurruese, për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një impiantit me një kapacitet prej

njëqind e dyzet (140) mwp në Remas – Karavasta, Lushnjë, dhe Libofshë, Fier, Shqipëri (“Projekti”), prej të cilave shtatëdhjetë (70) mwp e kapacitetit do të mbështetet nëpërmjet një marrëveshjeje për blerjen e energjisë elektrike (PPA) të konvertueshme në një kontratë për diferencë (CfD), me përmbushjen e disa kushteve të tregut (“Kapaciteti i Mbështetur”) dhe pjesa e mbetur nuk do të mbështetet (“Kapaciteti Tregtar”).

2. Objektivi i skemës: përmbushja e objektivave për sigurimin e energjisë së rinovueshme dhe diversifikimi i portofolit të prodhimit të energjisë së rinovueshme, dhe zvogëlimin e varësisë nga energjia elektrike e importuar.

3. Përfitues i masës: ofertuesi i përzgjedhur nëpërmjet procedurës konkurruese: Volitalia SA, një shoqëri e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Francës, me adresë të regjistruar në 84 Boulevard de Sébastopol, 75003, Paris Francë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Parisit, me numër 485 182 448. Karavasta Solar sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me NUIS M0202000IJ, zotëruar plotësisht në mënyrë indirekte nga Volitalia SA.

4. Përshkrimi i masës: sipas njoftimit të MIE-s, referohet se ofertuesit të përzgjedhur, i është ofruar mundësia e avantazheve ekonomike financiare ose të tjera pozitive, të cilat nuk do t'i kishte marrë në kushte normale të tregut, në formën e:

1. Një blerjeje të garantuar sipas një marrëveshjeje për blerjen e energjisë elektrike (PPA) nga një blerës i 50% të energjisë elektrike të prodhuar nga impianti, përcaktuar si 50% të prodhimit të matur ose prodhimit të nominuar (“Prodhimi i mbështetur”) me një çmim fiks ofertë të ofruar në proces konkurrues (çmimi i ofertës – 24,89 EUR/mwh) gjatë një periudhe 15-vjeçare, sipas marrëveshjes për blerjen e energjisë elektrike (PPA), për sa kohë që kushtet e konvertimit në CfD nuk janë përmbushur. Para ndodhjes së kushteve të konvertimit të CfD, një pjesë e rrezikut tregtar që lidhet me funksionimin e kapacitetit të mbështetur, duke përfshirë rrezikun që lidhet me mosdisponueshmërinë e blerësve në tregun me shumicë, luhatjet në çmimet e përdoruesve fundorë dhe kërkesa e përdoruesve fundorë i kalon blerësit sipas PPA-së. Prodhimi në tejkalim të prodhimit të mbështetur (“Prodhimi tregtar”) do të shitet në



tregun e lirë. Çmimi i energjisë elektrike, sipas PPA-së do të shërbejë si çmim fiks në CfD.

2. Me konvertimin e PPA-së nga një marrëveshje për blerjen e energjisë elektrike të shlyer fizikisht në një kontratë për diferencë (CfD) të shlyer financiarisht,¹ kur çmimi *fixed strike* (që i korrespondon çmimit të ofertës) është më i lartë se çmimi i referencës i lëvizshëm, përfituesit i ofrohet pagesa e CfD për prodhimin e mbështetur si një çmim shtesë mbi çmimin e tregut (çmim që i korrespondon diferencës midis çmimit referencë të lëvizshëm dhe çmimit fiks (*strike*)². Një konvertim i PPA-së në CfD do të realizohet, kur ndodh një rast konvertimi në përputhje me nenet 5.8 dhe 5.9 dhe shtojcën 4 të PPA-së dhe PDA-së, konkretisht kur të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

- Autoriteti Kompetent (ministria ose autoriteti rregullator ERE) të përcaktojë se energjia elektrike e prodhuar nga impianti duhet të jetë e disponueshme për blerje në tregun e organizuar të energjisë elektrike (i.e. Bursa e Energjisë ALPEX), në përputhje me modelin e tregut të energjisë

¹ Një konvertim i tillë në CfD do të realizohet kur ndodh një rast konvertimi në përputhje me nenin 5.8, 5.9 dhe shtojcën 4 të PPA-së dhe PDA-së, (i.e. me përcaktimin nga Autoriteti Kompetent se energjia elektrike e prodhuar nga impianti duhet të jetë e disponueshme për blerje në tregun e organizuar të energjisë elektrike, në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike të krijuar sipas legjislacionit të zbatueshëm; vendosjen e shkëmbimit të energjisë elektrike dhe ofrimin e çmimeve ekuilibër nga operatori i shkëmbimit të energjisë elektrike, të cilat janë të shpeshta dhe likuide sa duhet për të shërbyer si çmime të ndryshueshme reference ndaj çmimit të energjisë elektrike (si një çmim fiks) për të mundësuar zgjidhjen financiare bazuar në diferencën ndërmjet çmimit të ndryshueshëm dhe çmimit fiks; likuiditeti i mjaftueshëm i tregut të organizuar të energjisë elektrike përcaktohet nga një autoritet kompetent, bazuar në një vlerësim të thelluar të tregut me shumicë të energjisë elektrike, vlerësim i cili bëhet jo më herët se 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarikë pas krijimit të tregut të organizuar të energjisë elektrike dhe bazohet në një numër treguesish kryesorë, në përputhje me praktikën e mira të industrisë.

² Në një kontratë për diferencë (CfD) të konvertuar: i. çmimi i energjisë elektrike shërben si çmim fiks; ii. çmimet ekuilibër të tregjeve të energjisë elektrike shërbejnë si çmime të luhatshme referencë ndaj çmimit të energjisë elektrike, për të mundësuar shlyerjen financiare, duke iu referuar diferencës ndërmjet çmimit të luhatshëm dhe çmimit të energjisë elektrike; iii. dhe transferimi i kësaj marrëveshjeje një entitë të caktuar nga autoriteti kompetent që të veprojë si palë tjetër në një kontratë të konvertuar për diferencat, që mund të përfshijë operatorin e energjisë së rinovueshme ose një entitet tjetër, iv. çdo ndryshim tjetër që duhet t'i bëhet PPA-së, për të arritur (sa më shumë të jetë e mundur) të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, përgjegjësi, risqeve dhe shpërblimeve ndërmjet palëve lidhur me objektin e PPA-së, sikurse kërkohej në datën e hyrjes në fuqi.

elektrike të krijuar sipas legjislacionit të zbatueshëm;

- Të vendoset në operim Bursa e Energjisë ALPEX për shkëmbimin e energjisë elektrike dhe ofrimin e çmimeve ekuilibër nga operatori i ALPEX-it, të cilat duhet të jenë mjaftueshmërisht të shpeshta dhe likuide sa duhet për të shërbyer si çmime të ndryshueshme reference ndaj ÇMIMIT të energjisë elektrike (si një çmim fiks) për të mundësuar zgjidhjen financiare bazuar në diferencën ndërmjet çmimit të ndryshueshëm dhe çmimit fiks;

- Autoritetet kompetente (autoriteti rregullator ERE, pasi opinionit të Autoritetit të Konkurrencës) të vendosin në bazë të një analize të thelluar se ALPEX është në gjendje të prodhojë çmime të besueshme, mjaftueshmërisht të shpeshta dhe likuide, të cilat mund të konsiderohen si çmime tregu, në kuptim të EEAG, i.e. likuiditeti i mjaftueshëm i tregut të organizuar të energjisë elektrike përcaktohet bazuar në një vlerësim të thelluar të tregut me shumicë të energjisë elektrike, vlerësim i cili bëhet jo më herët se 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarikë pas krijimit të tregut të organizuar të energjisë elektrike dhe bazohet në një numër treguesish kryesorë, në përputhje me praktikën e mira të industrisë.

- Pas plotësimit të kushteve më lart, konsiderohet se ekziston një çmim tregu në Shqipëri në kuptim të udhëzimit të Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë (EEAG). Me ndodhjen e një rasti konvertimi, Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike PPA, me likuidim fizik duhet të konvertohet në një kontratë për diferencë me likuidim financiar, sipas afateve dhe kushteve të paracaktuara në përputhje me kërkesat e EEAG-së.

Ndryshimet që bëhen për konvertimin në CfD të dyanshme duhet të arrijnë (për aq sa të jetë e mundur) të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, detyrimeve, risqeve dhe shpërblimeve ndërmjet palëve në lidhje me objektin e PPA-së, sikurse janë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi për të reflektuar konvertimin.³

³ Për të implementuar një konvertim, me ndodhjen e një rasti konvertimi, secila Palë mund të njoftojë Palën tjetër duke kërkuar që Palët të takohen për të diskutuar konvertimin dhe, në mirëbesim, do të përpilojnë të bien dakord për ndryshimet e nevojshme që duhet të bëhen në PPA për të arritur (për aq sa të jetë e mundur) të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, detyrimeve, risqeve dhe shpërblimeve ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin



Në rast konvertimi në një CfD, dispozitat e PPA-së për livrimin dhe pagesën do të ndryshohen për të parashikuar çmimin e tregut për energjinë e prodhuar dhe ndarjen e elementit të shpërblimit të ndryshueshëm nga çmimi i tregut.

- Detyrimi i prodhuesit për shitjen e të gjithë energjisë së prodhuar në impiant në tregun e organizuar të energjisë elektrike (ALPEX).

- Çmimi i Energjisë Elektrike sipas PPA-së do të shërbejë si çmim fiks në CfD.

- Çmimi referencë i energjisë elektrike (EUR për mw) që do të përfshihet në CfD është çmimi orar i ditës në avancë për periudhën përkatëse, që do të caktohet nga burimi i çmimit referencë, ALPEX.

- Nga krahasimi midis çmimit fiks dhe çmimit referencë, pagesa e diferencës së çmimit/shpërblimit nga pala e CfD-së tek Shitësi apo anasjelltas.

- Pala e CfD-së do t'i paguajë prodhuesit shumën e barabartë me diferencën (nëse diferenca është pozitive) midis çmimit të energjisë elektrike të kontratës/çmimit fiks dhe çmimit referencë të energjisë elektrike shumëzuar me prodhimin e caktuar; apo

- Shitësi do t'i paguajë palës së CfD-së shumën e barabartë me diferencën (nëse diferenca është negative) midis çmimit fiks dhe çmimit referencë të energjisë elektrike shumëzuar me prodhimin e caktuar.

5. Dhënës i ndihmës: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore: Komisioni vlerëson nëse skema e njoftuar përmbush në mënyrë kumulative kushtet e parashikuara në paragrafin 1, të nenit 4, të ligjit nr.

e PPA-së, sikurse zbatohet në datën e hyrjes në fuqi për të reflektuar konvertimin.

Në qoftë se Palët nuk janë në gjendje të bien dakord për ndryshimet e konvertimit atëherë secila Palë do ta dërgojë çështjen për vendim në Qendrën për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për përcaktimin e ndryshimeve që duhet t'i bëhen për konvertimin në CfD që janë të nevojshme për të arritur (për aq sa të jetë e mundur) konvertimin, duke ruajtur të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, përgjegjësi, risqeve dhe shpërblimeve ndërmjet Palëve lidhur me objektin e PPA-së, sikurse zbatohen në datën e hyrjes në fuqi. Nëse një çështje nuk zgjidhet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pune (apo brenda një kohe të pranuar nga Palët) nga referimi për ndërmjetësim në Qendrën për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, secila nga Palët mund të nisë procedurat për arbitrazh ndërkombëtar në përputhje me dispozitën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sipas së cilës përcaktohet, se: “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”. Referuar të dhënave në skemën e njoftuar, operatori i përzgjedhur për gjenerimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme (panelet diellore) do të sigurojë një mbështetje nga burime shtetërore, për energjinë elektrike të gjeneruar, në rastin e një konvertimi të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike PPA me likuidim fizik në një kontratë për diferencë me likuidim financiar, në përputhje me nenin 5.8 dhe 5.9 të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike për Impiantin fotovoltai, me vendndodhje në zonën e Karavastasë dhe Libofshës në Shqipëri, nënshkruar ndërmjet FTL sh.a dhe “Karavasta Solar” sh.p.k., datë 19.11.2020 dhe shtojcën 4, “Konvertimi i marrëveshjes”, të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike.

Gjithashtu, referuar shtojcës nr. 2, “Forma e garancisë së pronarit”, që do të lidhet mes “garantuesit” (Republikës së Shqipërisë) dhe “përfituesit” (një shoqërie të themeluar në Republikën e Shqipërisë), sipas së cilës: “*Garantuesi ka rënë dakord që të garantojë që pala tjetër (përfituesi ose sipas rastit, Cesionari/ët e saj) do të përmbushin detyrimet për shyerjen e pagesave ndaj përfituesit sipas transaksionit*”. Për më tepër, referuar njoftimit të MIE-s, përcaktohet se: “*Ndryshimet që bëhen për konvertimin në CfD të dyanshme duhet të arrijnë (për aq sa të jetë e mundur) të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, detyrimeve, risqeve dhe shpërblimeve ndërmjet palëve në lidhje me objektin e PPA-së, sikurse janë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi për të reflektuar konvertimin*”. Pra skema e njoftuar parashikon aktivizimin e burimeve shtetërore. Duke qenë se energjia elektrike tregtohet në tregje ndërkombëtare, referuar të dhënave të skemës së njoftuar, ekziston mundësia që skema të ndikojë në situatën e konkurrencës në treg të energjisë elektrike treg dhe ndikojë në tregtinë ndërmjet



shtetesh. Si rrjedhim, skema e njoftuar përbën ndihmë shtetërore në kuptimin e nenit 4, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, e cila ndalohet, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

7. *Përputhshmëria e skemës.* Komisioni vlerëson se skema e njoftuar synon të nxisë prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, në përputhje me nenin 30, “Ndihma operationale për promovimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme”, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”, sipas së cilit ndihma operationale për promovimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme lejohet nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, nëse plotësohen kushtet e këtij neni dhe të kreut II të VKM-së nr. 513/2018.

Referuar njoftimit të MIE-s, rezulton se është ndjekur një procedurë konkurruese, në bazë të kriterëve të qarta, transparente dhe të paanshme, e hapur për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, siç reflektohet në dokumentet e procedurave konkurruese. Rregullat e përzgjedhjes së përfituesit për dhënien e mbështetjes nëpërmjet PPA të konvertueshme në CfD, parashikojnë sa më poshtë:

- Gjatë fazës së kualifikimit, ofertuesit të cilët kanë përvojën e kërkuar teknike, burimet financiare dhe statusin ligjor për të ofruar një projekt që plotëson kriteret e kualifikimit, siç përcaktohet në dokumentet e procedurës konkurruese, veçanërisht në aneksin 6, kualifikohen.

- Ofertuesit e kualifikuar vlerësohen në bazë të ofertës financiare që konsiston në çmimin fiks të propozuar nga ofertuesi të pandryshuar përgjatë afatit 15-vjeçar i shprehur në euro/mwh, për energjinë e prodhuar nga kapaciteti i mbështetur (çmimi i propozuar ky që nuk duhet të jetë mbi ulët se çmimi tavan) dhe renditen sipas kriterit të renditjes “Tarifa më e ulët e propozuar nga të gjithë ofertuesit/tarifa e cituar nga ofertuesi” (çmimi i ofertës fituese përcakton çmimin fiks të energjisë elektrike për PPA-në). Ofertuesit që paraqesin

prova të fondeve të besueshme dhe të verifikueshme për të mbuluar vlerën totale të investimit të propozuar marrin 10 pikë shtesë.

- Pra, shumat e ndihmës (i.e. çmimi i fiksuar i PPA-së, që do t'i korrespondojë çmimit fiks (strike) të CfD-së pas Konvertimit) përcaktohet përmes kësaj procedure konkurruese dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojë çmimin tavan.

- Të drejtat e përdorimit dhe gëzimit mbi vendndodhjen për ndërtimin e impiantit, si dhe të drejtat e servitutit për ndërtimin e linjës së transmetimit, transmetohen nëpërmjet së njëjtës procedurë konkurruese. Kohëzgjatja e mbështetjes kufizohet në 15 vjet nga data operationale e Projektit. Skema CfD do të ofrojë mbështetje financiare për përfituesit, duke ofruar pagesën e diferencës bazuar në prodhimin e siguruar të energjisë për një periudhë të caktuar prej 15 vjetësh pas investimit fillestar.

8. *Objektivi i interesit të përbashkët.* Qëllimi i skemës së ndihmës së njoftuar është të ndihmojë vendin që të arrijë sigurimin e prodhimit të energjisë së rinovueshme, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 28.8.2019, “Plani Kombëtar i Konsoliduar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme 2019–2020 (PKVER 2019–2020). Ndihma e njoftuar jepet përmes një procesi konkurrues dhe transparent, si pjesë e masave mbështetëse të parashikuara në ligjin për burimet e rinovueshme dhe VKM-në nr. 349, në mënyrë që Republika e Shqipërisë të arrijë objektivat e saj të energjisë së rinovueshme, të përmbushë detyrimet e reduktimit të emetimeve, të diversifikojë portofolin e saj të prodhimit dhe të zvogëlojë varësinë nga energjia elektrike e importuar, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 28.8.2019, “Plani Kombëtar i Konsoliduar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme 2019–2020 (PKVER 2019–2020). Sipas të dhënave të MIE-s, trajektorja udhëzuese në shtojcën 1, të ligjit nr. 7/2017, “Për energjinë nga burime të rinovueshme” tregon përqindjen detyruese të burimeve të energjisë së rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë në Shqipëri, që duhej të ishte arritur deri në 2020:



Pjesa e energjisë së rinovueshme të Shqipërisë në vitin 2009	Mesatarja për 2011–2012	Mesatarja për 2013–2014	Mesatarja për 2015–2016	Mesatarja për 2017–2018	Objektivi për energjinë e rinovueshme në vitin 2020
31,2 %	32,6 %	33,2 %	34,3 %	35,6 %	38 %

Ne seksionin 4.1.3, PKVER 2019–2020 përcakton, se: “Me qëllim arritjen e objektivit kombëtar të konsumit të BRE-ve, prej 38% në vitin 2020, është e domosdoshme një rritje e sasisë shtesë të konsumuar të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, me të paktën 159 ktoe deri në vitin 2020 (Objektivi kombëtar)”.

Kjo rritje shtesë është përkthyer në objektiva specifike, sipas sektorit dhe burimit të energjisë së rinovueshme në seksionin 4.2, “Sasitë e BRE-ve në Planin e Konsoliduar” PKVER 2019–2020, ku gjendet një tabelë përmbledhëse e BRE-ve për ngrohjen/ftohjen, transportin dhe energjinë elektrike, e cila ka përcaktuar sasitë dhe kapacitetet që duhej të shtoheshin për secilin burim gjatë vitit 2019 deri në fund të vitit 2020 në konsumin final bruto, me qëllim arritjen e objektivit kombëtar:

Teknologjitë shtesë të BRE 2018–2020		2018	Shtesat 2019–2020		
		Fakti (ktoe)	Sasia (ktoe)	Gjenerimi (gwh)	Instalimi (mw)
Zgjerimi me BRE-E	HECV deri në 15 mw	126	18.6	217	57
	Eolike (Wind)	0	47.7	555	150
	Fotovoltaike (PV)	0	68.0	784	490
	MNU	4	17.7	205	41
	Total 1 përfshirë në PKVBRE	130	152.0	1,761	738
BRE-N&F	Biomase drusore total 2 (ktoe)	0	0		
BRE-T	Biokarburante total 3 (ktoe)	20.3	20.0		
BRE	Total 1+2+3	150.3	172.0		
Totali	HEC + HECV (në operim 2018)	573.0	634.0	7,369	2,170
	Total BRE	723.0	806.0		
KFBE plan 2020 % e BRE në KFBE		2070	2,120		
		35%	38 %		

Sipas PKVER 2019–2020, objektivi kombëtar për PV është 490 mw deri më 2020–2021. Në mënyrë që objektivat e mësipërm të konsiderohen të plotësuar, duhet që kapacitetet të jenë ndërtuar dhe të jenë vendosur në operim.

9. *Nevoja për ndihmë shtetërore.* Sipas njoftimit të dhënësit të ndihmës, nevoja për dhënien e ndihmës shtetërore vjen si pasojë e pamundësisë së arritjes së objektivave të mësipërm brenda afatit të përcaktuar në (PKVER 2019–2020), për shkak të një kombinimi të dështimeve të tregut dhe pengesave të tjera, të cilat ndikojnë në mënyrë negative në tërheqjen e investimeve në kapacitete të mëdha fotovoltaike në Republikën e Shqipërisë, në mungesë të masave mbështetëse. Të tilla janë:

1. Eksternalitetet negative të tilla si ato që materializohen, për shkak se politikat aktuale nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme afatgjatë ose një sinjal të besueshëm çmimi për të lehtësuar investimet në fotovoltaikët diellorë në një kontekst kombëtar dhe ndërkufitar;

2. Eksternalitetet të tilla si pamjaftueshmëria e sigurisë në furnizim dhe mungesa e diversitetit të furnizimit nga tregu;

3. Eksternalitetet që çojnë në incentiva të pamjaftueshme për të arritur përfitime nga zhvillimi i teknologjive të pakonsoliduara në Shqipëri, që lind ndër të tjera nga një dështim në koordinim përmes aktorëve të ndryshëm;

4. Mungesa e një tregu likuid me shumicë të energjisë elektrike brenda Republikës së Shqipërisë; i tillë që të jenë në gjendje të gjenerojë çmime mjaftueshmërisht të shpeshta dhe likuide;

5. Mungesa e një tregu balancimi të zhvilluar dhe mirëfunksionues brenda Republikës së Shqipërisë;

6. Asimetria e informacionit në dëm të investitorëve të jashtëm ose financuesve, në lidhje me kthimet e investimit dhe rreziqet e mundshme të një projekti diellor fotovoltaik në shkallë të gjerë në Republikën e Shqipërisë,



7. Dështimet e tregut financiar, të cilat kufizojnë fondet në dispozicion për projektet e infrastrukturës energjetike;

8. Pasiguria juridike dhe mosnjohja e kontekstit lokal nga investitorë dhe aktorë me eksperiencë në projekte të ngjashme.

Për shkak të këtyre efekteve të vazhdueshme negative dhe dështimeve të tregut, investimi në shkallë të gjerë në kapacitete fotovoltaike mund të mos jetë i mundur pa ndërhyrjen e shtetit. Aktualisht nuk ekziston asnjë projekt i madh në energji diellore, përveç disa aplikimeve në instalacione të vogla të cilat përfitojnë mbështetje administrative të formës *feed-in tariff*.

10. *Përdorimi i instrumentit* të përshtatshëm. Komisioni vlerëson, se për shkak të eksternaliteteve të vazhdueshme negative, të vlerësuara nga MIE, sigurimi i prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë nuk do të ishte financiarisht e qëndrueshme pa ndihmën shtetërore, si rrjedhim ndihma ka një efekt nxitës, pasi lejon që përfituesit të ndryshojnë sjelljen e tyre dhe të investojnë në projekte të energjisë së rinovueshme.

11. *Proporcionaliteti*. Ndihma ofrohet në formën e premium mbi çmimin e tregut, ku prodhuesit duhet të shesin elektricitetin direkt në treg të lirë. MIE vlerëson se në përputhje me kërkesat e EEAG, veçanërisht pikës 124, me krijimin e një tregu funksional dhe likuid të organizuar me shumicë, PPA do të konvertohet në CfD. Në bazë të CfD-së, prodhuesi duhet të shesë energjinë e tij elektrike direkt në treg dhe ndihma do të jepet në formën e një premium të ndryshueshëm simetrik mbi çmimin e referencës për energjinë elektrike (ky premium konsiston në diferencën midis çmimit fiks (strike) dhe çmimit të referencës së energjisë elektrike në rast se kjo diferencë është pozitive; në rast se diferenca është negative prodhuesi detyrohet të paguaje mbrapsht tek OER premium korrespondues). Me ndodhjen e një Rasti Konvertimi, Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike PPA me likuidim fizik duhet të konvertohet në një kontratë për diferencë me likuidim financiar, sipas afateve dhe kushteve të paracaktuara në përputhje me kërkesat e EEAG-së.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se skema e ndihmës e njoftuar mundëson realizimin e një objektivi me interes të përbashkët të rëndësishëm, në mënyrë proporcionale dhe se ndihma është në

përputhje me tregun e brendshëm në bazë të VKM-së nr. 531/2018.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 13/1, 20, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore të njoftuar “Për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e impiantit fotovoltaike, me kapacitet prej njëqind e dyzet (140) mwp në Remas – Karavasta, Lushnjë”, mbështetur në nenin 13/1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

2. Ministri përgjegjës për energjinë të respektojë dispozitat e parashikuara në nenin 30, të VKM-së nr. 531/2018 lidhur me sa vijon:

- ndihma për teknologjitë e reja demonstruese nuk do të jepet për më shumë se 5% të kapacitetit të ri të planifikuar për energjinë elektrike nga burime të energjisë së rinovueshme, për çdo vit në total;

- ndihma jepet si shtesë mbi çmimin e tregut, nëse çmimi i tregut është më i ulët se çmimi fiks fitues në procesin konkurrues;

- përfituesit e ndihmës duhet t’u nënshtrohen përgjegjësi standarde të balancimit;

- ndihma nuk duhet të jepet kur çmimet janë në nivelin negativ.

3. Ministri përgjegjës për energjinë, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Ministri përgjegjës për energjinë të njoftojë çdo ndryshim të planit të ndihmës.

5. Ministri përgjegjës për energjinë të ruajë deri në dhjetë vjet të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Delina Ibrahimaj



VENDIM

Nr. 150, datë 28.4.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213,
SERIA PM13P, PËR PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-i
“SHKOPET”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 13 dhe 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nr. 133/5 prot., datë 27.4.2023, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Kurum International” sh.a. për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 56, datë 24.2.2023, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”, i shoqërisë “Kurum International” sh.a., nga 24 mw në 28 mw.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.2.2023 dhe 29.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 133/3 prot., datë 3.3.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 133/4 prot., datë 24.4.2023.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,

transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria “Kurum International” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”: plotësuar.

- Leja e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor për HEC “Shkopet” ka afat vlefshmërie 5 (pesë) vjet deri më datë 2.3.2025. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë “Kurum International” sh.a. që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidroenergjie nga HEC-i “Shkopet”, brenda datës 2.3.2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, tek shoqëria “Kurum International” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”, si më poshtë:

Ishte: kapaciteti i instaluar 24 mw.

Bëhet: kapaciteti i instaluar 28 mw.

2. Në përmbajtjen e licencës nr. 213, seria PM13P, të pasqyrohen ndryshimet respektive në përputhje me rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC-it “Shkopet”.

3. Shoqëria “Kurum International” sh.a. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidroenergjie nga HEC-i “Shkopet”, brenda datës 2.3.2025.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit nga ana e shoqërisë të kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Kurum International” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujqore dhe shoqërinë “Operatori Sistemit Transmetimit” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga



data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 151, datë 28.4.2023

**MBI PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË
GARANCISË SË ORIGINËS TË
IMPIANTIT TË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE HEC “BANJË”,
TË SHOQËRISË “DEVOLL
HYDROPOWER” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të nenit 14 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 229, datë 20.12.2019; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 901/6 prot., datë 26.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës të impianteve të prodhimit të energjisë elektrike HEC ‘Banjë’ dhe HEC ‘Moglicë’, të shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.a., për periudhën 1.1.2022–31.12.2022”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 901/1 prot., datë 28.3.2023, ka paraqitur kërkesën për pajisjen me certifikatën e garancisë së origjinës për

impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, për vitin 2022.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 47, datë 23.3.2022, është vendosur pajisja me certifikatë të garancisë së origjinës, për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, për vitin 2021.

- Referuar nenit 14.2, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për certifikatë garancie origjine do të depozitojë në ERE, për qëllime të këtij aplikimi, vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 901/5 prot., datë 20.4.2023, shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. ka bërë me dije se nuk ka asnjë ndryshim të dokumentacionit respektiv për këtë central prodhues.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 901/4 prot., datë 19.4.2023, “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. ka informuar se sasia totale e energjisë elektrike e prodhuar për vitin 2022 nga HEC “Banjë” është 167,931 mwh.

- Në zbatim të nenit 14.1 të rregullores, garancia e origjinës lëshohet për një periudhë 12-mujore dhe shteron fuqinë e saj me përfundimin e këtij afati, të shprehur edhe në certifikatën e lëshuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pajisë me certifikatë të garancisë së origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. për një periudhë 12-mujore (1.1.2022–31.12.2022), për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 167,931 mwh.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund



ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 152, datë 28.4.2023

**MBI PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË
GARANCISË SË ORIGINËS TË
IMPIANTIT TË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE HEC
“MOGLICË”, TË SHOQËRISË “DEVOLL
HYDROPOWER” SHA**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16 të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 14 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 229, datë 20.12.2019; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 901/6 prot., datë 26.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës të impianteve të prodhimit të energjisë elektrike HEC ‘Banjë’ dhe HEC ‘Moglicë’, të shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.a., për periudhën 1.1.2022–31.12.2022”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 901/1 prot., datë 28.3.2023 ka paraqitur kërkesën për pajisjen me certifikatën e garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, për vitin 2022.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 64, datë 11.4.2022, është vendosur pajisja me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, për vitin 2020 dhe 2021.

- Referuar nenit 14.2 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për certifikatë garancie origjine do të depozitojë në ERE për qëllime të këtij aplikimi vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 901/5 prot., datë 20.4.2023, shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. ka bërë me dije se nuk ka asnjë ndryshim të dokumentacionit respektiv për këtë central prodhues.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 901/4 prot., datë 19.4.2023, “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. ka informuar se sasia totale e energjisë elektrike e prodhuar për vitin 2022 nga HEC “Moglicë” është 322,491 mwh.

- Në zbatim të nenit 14.1 të rregullores, garancia e origjinës lëshohet për një periudhë 12-mujore dhe shteron fuqinë e saj, me përfundimin e këtij afati, të shprehur edhe në certifikatën e lëshuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pajisë me certifikatë të garancisë së origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. për një periudhë 12-mujore (1.1.2022–31.12.2022), për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 322,491 mwh.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të



ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 153, datë 28.4.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “DUKA T2” SHPK PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 12, DATË 23.1.2020 DHE MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 190, SERIA PV13K, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në zbatim të nenit 16, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të neneve 15 dhe 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.4.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1139/1 prot., datë 27.4.2023, të për gatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Duka T2’ sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 12, datë 23.1.2020 dhe modifikimin e licencës nr. 190, seria PV13K, lëshuar në datën 18.3.2013”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Duka T2” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 190, seria PV13K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 30, datë 18.3.2013, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Tucep 2”.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 12/2020, janë miratuar disa ndryshime në kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike mes shoqërisë së ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1139 prot., datë 28.3.2023, shoqëria “Duka T2” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 12, datë 23.1.2020 dhe modifikimin e licencës nr. 190, seria PV13K, lëshuar më datë 18.3.2013.

- Në kërkesën e saj për rishikimin e vendimit nr. 12/2020, shoqëria referon se një ndër kërkesat e këtij vendimi është transferimi i kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë koncesionare “Duka T2” e HEC “Tucep2”, nga OSHEE sh.a., te shoqëria FTL sh.a. Për këtë shoqëria bën me dije se ka krijuar një shoqëri të re në datën 11.1.2023, sipas kontratës së koncesionit dhe kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, me nr. 2480, datë 17.8.2020. Shoqëria shprehet se i ka kërkuar FTL-së revokimin e kontratës së mëparshme dhe FTL sh.a. i ka bërë me dije se është kompetencë e ERE-s zgjidhja e kësaj problematike.

- Rezulton se me vendimin e Bordit nr. 12/2020 është vendosur, ndër të tjera që, për subjektet që kanë një kontratë të shitblerjes së energjisë elektrike me OSHEE sh.a. para apo në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të ERE, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë FTL sh.a., do të lidhet për periudhën e mbetur nga përfundimi i kontratës së lidhur me OSHEE sh.a. Ky vendim i referohet të gjithë të licencuarve që kanë lidhur kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike me OSHEE sh.a. përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe nuk i drejtohet një të licencuari në veçanti, siç citohet vetë nga shoqëria “Duka T2” sh.p.k.

- Në kërkesën e shoqërisë për rishikimin e këtij vendimi, nuk evidentohet ndonjë referencë ligjore apo përcaktim i këtij vendimi që kërkohet të ndryshohet apo shfuqizohet, por referohet vetëm fakti që kërkohet të nënshkruhet me një subjekt që nuk është i licencuar nga ERE. Për më tepër, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike mes shoqërisë së ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi, e miratuar nga ERE, është një kontratë tip “Për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve



me përparësi të energjisë elektrike” dhe nuk referon një palë të caktuar sa i takon të licencuarve.

- Për sa i përket kërkesës për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, sqarojmë se shoqëria nuk rezulton të ketë depozituar asnjë nga dokumentet e kërkuara në nenin 43, të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, dhe nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nuk rezulton të jetë kryer pagesa e aplikimit.

- Gjithashtu, bazuar në përcaktimet e nenit 95, pika 5, të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, parashikohet se: nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe. Nga verifikimi i kryer në QKB rezulton se statuti i shoqërisë nuk i përmban ndryshimet që ka pësuar struktura e shoqërisë ndërkohë kërkesa e depozituar pranë ERE-s rezulton se nuk është e nënshkruar nga të dy administratorët e shoqërisë, sikurse përcaktohet në dispozitat e ligjit të sipërcituar pasi sipas ekstraktit të QKB-së rezulton se shoqëria ka emëruar më shumë se një administrator të cilët duhet të administrojnë bashkërisht shoqërinë.

- Po ashtu, nga shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë për modifikim licence, duke marrë në konsideratë faktin që referon se ka krijuar një shoqëri të re dhe kërkon që të jetë kjo shoqëri e cila të vazhdojë marrëdhënien për shitblerjen e energjisë elektrike me FTL sh.a., mund të jemi në rrethanat e transferimit të licencës, sikurse parashikuar në nenin 17, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ku përcaktohet dokumentacioni që duhet depozituar në ERE në rastin e transferimit të një licence, dokumentacion të cilin gjithashtu shoqëria nuk e ka depozituar në ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë “Duka T2” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 12, datë 23.1.2020.

2. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë “Duka T2” sh.p.k. për modifikimin e licencës nr. 190, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 30, datë 18.3.2013.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Duka T2” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 156, datë 2.5.2023

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 1” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 884/10 prot., datë 28.4.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe



Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 1’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 64, datë 3.3.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 4.3.2023 dhe 5.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 13.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s.

- Me shkresën nr. 884/3 prot., datë 10.3.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., duke e njoftuar mbi fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar.

- Rezulton se shoqëria nuk ka depozituar ende miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit. Më datë 14.4.2023, u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqëritë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. dhe “Operatori i Sistemit Transmetimit” (OST) sh.a. dhe nga përfaqësuesit e shoqërisë në seancë u deklarua se miratimi përfundimtar i pikës së lidhjes është në proces dhe pritet të finalizohet brenda 15 ditësh. Duke qenë se nga shoqëria nuk u depozitua miratimi për pikën e lidhjes, me e-mailin e datës 27.4.2023, iu kërkuu asaj të sqaronte fazën në të cilën ndodhej marrja e këtij miratimi dhe shoqëria ka bërë më dije se kërkesa e saj është marrë në shqyrtim nga OST sh.a. dhe se afati i parashikuar për pajisjen me dokumentacionin për “Marrëveshja e lidhjes” me OST sh.a. parashikohet të jetë brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të këtij e-maili.

- Në nenin 14, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, parashikohet se: Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit që shoqëria duhet të dorëzojë në lidhje me miratimin e operatorit të rrjetit OST sh.a., për lidhjen e centralit fotovoltai, vlerësohet të zgjatet deri në 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës.

- Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e kërkuar, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja në dijeni e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 20 (njëzet) ditë pune afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 179, datë 29.5.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA PRODHUESIT EKZISTUES ME PËRPARËSI NGA BURIMET FOTOVOLTAIKE DHE EOLIKE, PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 10, pika 5, nenit 29, pika 1 dhe nenit 31, pika 2, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, “Për



miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; dhe të nenit 19, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 1469 prot., datë 24.5.2023, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike”,

konstatoi se:

- Më datë 29 prill 2023 ka hyrë në fuqi ligji nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i ndryshuar.

- Ligji nr. 24/2023, në pikën 5, të nenit 10, ngarkon ERE-n me detyrimin për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, e cila duhet të ketë të përcaktuara kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

- Mbështetur në pikën 37, të nenit 3, të ligjit nr. 24/2023, “Prodhues ekzistues me përparësi” është një prodhues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues fotovoltaike deri në 2 mw, eolik deri në 3 mw dhe për hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri në 15 mw.

- Mbështetur në pikën 2, të nenit 31, aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

- Për sa më sipër, në zbatim të nenit 29, pika 1 dhe nenit 31, pika 2, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e

rinovueshme”, për sa kohë nuk është miratuar një metodologji e re për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike do të vazhdojë të përdoret metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369/2017, në zbatim të ligjit nr. 7/2017, për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli deri në 2 mw dhe era deri në 3 mw për prodhuesit ekzistues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues.

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të saj, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM, për sa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

- Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

- ERE, me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuesve ekzistues me përparësi do t'i drejtohet MIE-s për informacion lidhur me subjektet të cilët që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose janë pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues.

- Ky informacion do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar



nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike, për vitin 2023.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 180, datë 29.5.2023

**MBI KËRKESËN E OPERATORIT TË
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST)
SHA, PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES “MBI PEZULLIMIN
DHE RIVENDOSJEN E AKTIVITETIT
TË TREGUT, RREGULLAVE PËR
SHLYERJEN E DISBALANCave,
KAPACITETIT BALANCUES DHE
ENERGJISË BALANCUESE, PËR
PERIUDHËN GJATË SË CILËS
AKTIVITETET E TREGUT JANË
PEZULLUAR”**

Në mbështetje të neneve 16, 19 dhe 62, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, “Kodit të Transmetimit”, i miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 63, datë 11.4.2022; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.5.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1363/3 prot., datë 24.5.2023 të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi kërkesën e OST sh.a., për miratimin e rregullores ‘Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të

tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të cilat janë në fuqi por nuk kanë të përcaktuar mënyrën e operimit të balancimit në rastet e pezullimit dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut të balancimit, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.

- Gjithashtu ERE, me vendimin nr. 63, datë 11.4.2022, ka miratuar Kodin e Transmetimit, i cili ka hyrë në fuqi më datë 1.7.2022. Në pikën 2, të vendimit nr. 63, datë 11.4.2022, është përcaktuar se: “OST sh.a. duhet të rishikojë dhe të plotësojë të gjitha aktet që ndikohen nga ndryshimet në Kodin e Transmetimit përfshirë marrëveshjen e operimit dhe t'i përcjellë ato në ERE konform përcaktimeve ligjore në fuqi deri më 30 prill 2023”.

- OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 2974 prot., datë 28.4.2023, të protokolluar në ERE me nr. 1363 prot., datë 4.5.2023, ka përcjellë kërkesën për miratim të rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”.

- OST sh.a. në këtë shkresë bën me dije se: Enti Rregullator i Energjisë, me vendimin nr. 63, datë 11.4.2022, ka miratuar Kodin e Transmetimit, i cili ka hyrë në fuqi më datë 1.7.2022. Në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, OST sh.a. duhet të rishikojë dhe të plotësojë të gjitha aktet që ndikohen nga ndryshimet në Kodin e Transmetimit dhe t'i përcjellë ato në ERE, konform përcaktimeve ligjore në fuqi. Në këto kushte OST sh.a. është angazhuar prej muajit korrik 2022 për hartimin e të gjitha dokumenteve të cilët lindin si detyrim i zbatimit të Kodit të Transmetimit dhe së fundmi ka finalizuar hartimin e rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues, energjisë balancuese për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar, si dhe kërkesave teknike që



duhen plotësuar nga sistemet e komunikimeve zanore”.

- OST sh.a. shprehet se rregullorja e përgatitur “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar” është dërguar për shqyrtim dhe në palët e interesit dhe komentet janë shqyrtuar nga OST sh.a.

- Rregullorja e paraqitur nga OST sh.a., është e përbërë nga 16 nene të cilat përcaktojnë elementet e nevojshëm për pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.

- Shoqata Shqiptare e Furnizueseve të Energjisë Elektrike (AAES) nëpërmjet shkresës nr. 6/1 prot., datë 9.5.2023, ka përcjellë komente lidhur me draft rregullat “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullat për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.

- Duke qenë se aktualisht ERE është në fazën e fillimit të procedurës së shqyrtimit të këtyre rregullave komentet e AAES si dhe komentet që do të merren nga palët e tjera të interesit do të shqyrtohen dhe trajtohen në të njëjtën kohë para vendimit përfundimtar të kësaj procedure.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e rregullave “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”.

2. Drejtoria Juridik dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OST sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të

ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 182, datë 29.5.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SOLE 24 DOOEL SHKUP–DEGA NË SHQIPËRI” DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1433/1 prot., datë 26.5.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri’, degë e shoqërisë së huaj, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri”, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1433 prot., datë 19.5.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e



licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri”, degë e shoqërisë së huaj, ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”, si dhe për pikën 2.4, germën “a”.

- Nga ky aplikim rezultojnë mungesa në dokumentacionin si më poshtë:

- *Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- germa “a”: vlerësohet t’i kërkohej shoqërisë që të përfshijë veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike në objektin e ekstraktit në regjistrin tregtar të depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

- germa “b”: referuar kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë dëshmitë e penaltetit, për vetë shoqërinë dhe administratoren.

- *Pika 2.4. Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- germa “b”: shoqëria ka referuar se ka depozituar bashkëlidhur kontratën mbi sistemin IT që do të operojë por me qëllim për të kuptuar më shumë rreth këtij shërbimi, vlerësohet që t’i kërkohej që në vijim të depozitojë në ERE këtë kontratë;

- germa “c”: referuar dokumentacionit të depozituar, rezulton se shoqëria ka një kontratë të vlefshme për disponimin e zyrave për të ushtruar aktivitetin e furnizimit. Afati i vlefshmërisë së kontratës është 1-vjeçare dhe nuk mbulon të 5 vjetët e licencës, ndaj vlerësohet që t’i kërkohej shoqërisë informacion mbi disponimin e zyrave përkatëse pas përfundimit të kësaj kontrate.

- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 183, datë 29.5.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SOLE 24 DOOEL SHKUP–DEGA NË SHQIPËRI” DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin,



rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1432/1 prot., datë 26.5.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri’, degë e shoqërisë së huaj, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri”, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1432 prot., datë 19.5.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri”, degë e shoqërisë së huaj, ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat: “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat: “a”, “b” dhe “c”, si dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim rezultojnë mungesa në dokumentacionin si më poshtë:

Pika 1.2, dokumentacioni juridik dhe administrativ

germa “b”: shoqëria nuk ka depozituar në ERE vërtetimet e gjendjes gjyqësore për shoqërinë, si edhe për administratorin e saj, ndaj në vijim do t'i kërkohej t'i përcjellë ato.

- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri”, degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 184, datë 29.5.2023

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË
10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘ALBGAS’ SHA NË
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË
GAZIT NATYROR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 72/3 prot., datë 25.5.2023, të drejtorive teknike të ERE-s, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, ‘Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror’, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, ‘Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 352, datë 28.12.2022, vendosi të ndryshojë pikën 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar, si më poshtë:

1. “Të licencojë shoqërinë ‘Albgaz’ sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.4.2023, të depozitojë në ERE certifikatën e sigurimit.”.

- ERE njoftoi shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës nr. 72 prot., datë 11.01.2023 dhe me shkresën nr. 72/1 prot., datë 24.3.2023 i kujtoi shoqërisë detyrimin për të depozituar në ERE brenda afatit dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 352/2022, të bordit të ERE-s, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 72/2 prot., datë 25.4.2023, informoi ERE-n se në

shkresën nr. 138 prot., datë 19.1.2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me zbatimin e rregullave për periudhën kohore 13 janar 2023 deri më 14 maj 2023, nga të gjitha institucionet publike dhe entet e tjera ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit është përcaktuar ndër të tjera se “*Ndalohet promovimi i projekteve të ndryshme në investime për të cilat fondet janë planifikuar pas datës 13 janar 2023 dhe jashtë programit vjetor buxhetor të miratuar në fillim të vitit*”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. ka miratuar buxhetin vjetor me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 1, datë 1.2.2023 dhe shpenzimi përkatës për certifikatën e sigurimit është i parashikuar në buxhetin e miratuar me këtë vendim. Në këto kushte, shoqëria “Albgaz” sh.a., duke qenë se e ka miratuar buxhetin pas datës 13 janar 2023, mbetet në pritje për vijimin e procedurës për kryerjen e shpenzimeve për certifikatën e sigurisë deri në përfundimin e zgjedhjeve vendore të datës 14.5.2023 dhe më pas do të vijojë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

- Për sa më sipër, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka kërkuar shtyrjen deri më datë 30.8.2023 të afatit për depozitimin e certifikatës së sigurimit për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Duke marrë në konsideratë argumentet e shoqërisë dhe faktin që kjo vonesë ka qenë përtej vullnetit të saj si dhe kohën që i nevojitet për të miratuar buxhetin përkatës në Asamblenë e Përgjithshme dhe ndjekjen e procedurës për përzgjedhjen e ofruesit të këtij shërbimi dhe nënshkrimin e certifikatës përkatëse, vlerësohet të pranohet kërkesa e shoqërisë për zgjatjen e afatit të depozitimit të saj deri më datë 30.8.2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1 të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar, si më poshtë:

“1. Të licencojë shoqërinë ‘Albgaz’ sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.8.2023, të depozitojë në certifikatën e sigurimit.”.

2. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 1.5.2023.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 185, datë 29.5.2023

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË
10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘ALBGAZ’ SHA NË
AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË
GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me

nr. 72/3 prot., datë 25.5.2023, të Drejtorive Teknike të ERE-s, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar, dhe një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188 datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 353, datë 28.12.2022, vendosi të ndryshojë pikën 1 të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

“1. Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.4.2023, të depozitojë në ERE certifikatën e sigurimit.”.

- ERE njoftoi shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës nr. 72 prot., datë 11.1.2023, dhe me shkresën nr. 72/1 prot., datë 24.3.2023, i kujtoi shoqërisë detyrimin për të depozituar në ERE brenda afatit dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 353/2022, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 72/2 prot., datë 25.4.2023, informoi ERE-n se në shkresën nr. 138 prot., datë 19.1.2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me zbatimin e rregullave për periudhën kohore 13 Janar 2023 deri më 14 Maj 2023, nga të gjitha institucionet publike dhe entet e tjera ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, është përcaktuar ndër të tjera se: “Ndalohej promovimi i projekteve të ndryshme në investime për të cilat fondet janë planifikuar pas datës 13 janar 2023 dhe jashtë programit vjetor buxhetor të miratuar në fillim të vitit”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. ka miratuar buxhetin vjetor me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. L, datë 1.2.2023 dhe shpenzimi përkatës për certifikatën e sigurimit është i parashikuar në buxhetin e miratuar me këtë vendim. Në këto kushte, shoqëria “Albgaz” sh.a., duke qenë se e ka miratuar buxhetin e saj pas datës 13 Janar 2023, mbetet në pritje për kryerjen e shpenzimeve për certifikatën e sigurisë deri në përfundimin e zgjedhjeve vendore të datës 14.5.2023 dhe më pas



do të vijojë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

- Për sa më sipër, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka kërkuar shtyrjen deri më datë 30.8.2023 të afatit për depozitimin e certifikatës së sigurimit për aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

- Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr. 44.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Duke marrë në konsideratë argumentet e shoqërisë dhe faktin që kjo vonesë ka qenë përtej vullnetit të saj, si dhe kohën që i nevojitet për të miratuar buxhetin përkatës në Asamblenë e Përgjithshme dhe ndjekjen e procedurës për përzgjedhjen e ofruesit të këtij shërbimi dhe nënshkrimin e certifikatës përkatëse, vlerësohet të pranohet kërkesa e shoqërisë për zgjatjen e afatit të depozitimit të saj deri më datë 30.8.2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

“1. Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.8.2023, të depozitojë në ERE certifikatën e sigurimit.”.

2. Ky vendim i shtrín efektet duke filluar nga data 1.5.2023.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë